

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues i përbërë prej gjyqtarit Skender Çoçaj, kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve Gani Kastrati e Nazim Vllaqo, anëtarë, me procesmbajtësen Birsën Kume, në lëndën penale kundër të akuzuarit S.G. nga fshati , Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale dhunimi nga neni 230 paragrafi 1 i KP-së, veprës penale degradimi i integritetit seksual nga neni 233 paragrafi 1 të KP-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.20/2014 të datës 26.01.2015, pas shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Sefer Morina, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.H.K. , më datë 23.06.2016 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S.G. , nga i ati S. dhe e ëma N. , e lindur F., i lindur më dt. “data e lindjes ..” në fshatin , Komuna e Dragashit, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I.

Në mbështetje të nenit 364 pika 1.3 të KPP-së.

LIROHET NGA AKUZA

Se gjatë periudhës kohore prej muajit Gusht 2013 e deri me datë 21.10.2013, në Prizren, e detyron personin tjetër që të kryej akt seksual, duke e frikësuar me zbulimin e faktit i cili do të dëmtonte rëndë nderin dhe moralin, në atë mënyrë që duke u prezentuar me emrin e rrejshëm si A. , pasi njoftohet, takohet disa herë me të dëmtuarën S.A. në restorant “.....” dhe qendrën tregtare “ ...-..”, të cilën e mashtron, kinse është i interesuar të fejojhet dhe martohet me të por për këtë insiston që në çdo kushte paraprakisht të bëjë marrëdhënie seksuale me të, ashtu që gjatë një takimi në “...-..”, e dërgon në toalet dhe detyrimisht kërkon të bëjë marrëdhënie, pasi e dëmtuara refuzon, atëherë e bindë që pa pëlqimin e saj të kryej akt oral seksual rreth 20 minuta, dhe i thotë nëse nuk e bënë këtë dhe nuk del përsëri me mua për të kryer marrëdhënie, do të qes në internet të gjitha fotografitë tua duke bërë marrëdhënie me mua, se do ta prishi punën dhe jetën kur të martohesh dhe kam me i tregu burrit që ke pas marrëdhënie me mua.

Këso dore do të kryente veprën penale dhunimi nga neni 230 par.1 të KP-së.

- Për shkak se nuk është provuar që i akuzuari të ketë kryer këtë vepër penale.

II.

ËSHTË FAJTOR

1. Se gjatë vitit 2013 në vazhdimësi deri me datë 21.01.2014 në Prizren me dashje për ti bindur me anë të premtimit të rrem dhe mashtrimit, i cyt (nxit) personat tjerë të gjinisë femërore ti ekspozojnë pjesët intime të trupit, të masturbojnë dhe kryejnë akt seksual, me qëllim për ti kënaqur epshet e veta pa pëlqim dhe vullnet të tyre, në atë mënyrë që prezantohet si zyrtar i një Shoqate Humanitare Ndërkombëtare nga Prishtina, kinse do të dërgon familje të varfër në shtetin e Evropës si në Austri, Belgjik, Danimarkë, Kanada Amerikë etj, që ti punësoj nëpër shtëpi të pleqve, ashtu që pasi bie në kontakt me të dëmtuarat Sh.B. , A.P. dhe R.F. , me të cilat më pas takohet disa herë me to duke ju thënë se paraprakisht duhet ti plotësojnë disa kushte të kërkuar, të cilat janë : të zhvishen lakuriq, ti fotografojë dhe kontrollojë të zhveshura se si duken në trup, të dëmtuarën Sh.B. së bashku me dy shoqet e saj A.P. dhe R.F. , i dërgon në objektin e firmës “...” i fut në një dhomë që të zhvishen lakuriq, i fotografon me aparat dhe më pas përmes një gypi të plastikës i shikon të zhveshura duke i ekspozuar pjesët intime të trupit.

- Me këto veprime, ka kryer veprën penale degradimi i integritetit seksual nga neni 233 par.1 të KP-së.

2. Se me datë 21.01.2014 rreth orës 15:00 në fshatin , komuna e Dragashit, me rastin e kontrollit të kryer nga policia në shtëpinë e tij, i janë gjetur armë të zjarrit dhe atë : një pushkë automatike e modelit “Type 68” kalibër 7.62 x 93 mm me nr.serik 101122013, 15 (pesëmbëdhjetë) copë fishek –municion të kalibrit 7.62 x 39 mm, 2 (dy) karikator të zbrazur të dizajnuar për pushkë automatike të tipit AK-47, një karikator të zbrazur për fishekë të kalibrit 7.62 x 39 mm të dizajnuar për pushkë automatike “Type-69”, 1 (një) pushkë me veprim me shule e model “carcano fat-41” e kal.6.5 x 53 mm, me nr.serik 24321 si dhe 30 (tridhjetë) copë fishek-municion e kal. 65 mm “Carcano” që të gjitha funksionale, të cilat mbante në pronësi dhe përdorim të pa autorizuar dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët.

Me këto veprime ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374par. 1 të KP-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të nenit 4, 7, 17, 41,45,46,73,83 dhe neneve 233 par.1 të KP-së, dhe nenit 374 par. 1 të KP-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- Për veprën penale nën II/1 të shqiptimit dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 21.01.2014 deri më datën 20.04.2014,

-Për veprën penale nën II/2 të shqiptimit, dënimi me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) euro, të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk e paguan apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjoba do ti zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim.

Në pajtim me dispozitën e nenit 374 par.3 të akuzuarit Samet Guraj i konfiskohet një pushkë automatike e modelit "Type-68" kalibër 7.62 x 93 mm me nr. serik 101122013, 15 copë fishekë të kalibrit 7.62 x 93 mm, dy karikatorë të zbrazur të dizajnuar për pushkë automatike të tipit AK 47, një karikator të zbrazur për fishekë të kalibrit 6.62 x 93 mm të dizajnuar për pushkë automatike "Type-68, një pushkë me veprim me shule e modelit "Carcano fat-41" e kal.6.5 x 53 mm me nr.serik 24321 si dhe 30 copë fishekë municion të kal.65 mm "Carcano".

Te dëmtuarat Sh.B. , A.P. dhe R.F. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest te rregullt civilo juridik.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguajë paushallin gjyqësor në lartësi prej 100 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën kundër të akuzuarit S.G. nga Prizreni, për shkak të veprës penale dhunimi nga neni 230 paragrafi 1 i KP-së, veprës penale degradimi i integritetit seksual nga neni 233 paragrafi 1 të KP-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 KP-së, pranë së cilës prokurori I shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka qëndruar në tërësi duke potencuar se nga e tërë rrjedha e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale provat të cilat janë administruar gjatë seancave gjyqësore para këtij trupi gjykues, veçmas nga dëshmitë e të dëmtuarave në cilësinë e dëshmitarëve, provave materiale të cilat ekzistojnë në shkresat e lëndës të bashkangjitura me aktakuzën e po ashtu edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit të dhënë në prokurori por edhe në deklaratën e tij të dhënë në procedurën para penale në polici i cili edhe ka pranuar veprat penale të kryera e gjithashtu pjesërisht edhe nga mbrojtja e të akuzuarit të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë të padyshimtë dhe në tërësi është vërtetuar gjendja faktike në këtë çështje penale se këtu i akuzuari në veprimet e tija i ka kryer këto vepra penale, andaj, nga të gjitha këto prova, të cilat janë shqyrtuar në gjykimin e kësaj çështje penale, kërkoj që gjykata përkatësisht trupi gjykues nga këto prova të akuzuarin ta nxjer dhe shpall fajtor për veprat penale të lartëcekura dhe njëherit ti shqiptojë denim të paraparë sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.G. - avokati H.K., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se aktakuza e prokurorisë themelore në Prizren e ngritur ndaj të akuzuarit S.G. konsiston me dyshimin se i njëjti ti ketë kryer 3 vepra penale të përshkruara në këtë aktakuzë, e cila mbanë numrin PP.nr.20/2014 të datës 26.01.2015, në fakt i mbrojturi im gjatë deklaramit lidhur me këtë aktakuzë për këto tri vepra penale është deklaruar se veprën nën I dhe II të aktakuzës nuk e pranon, ndërkaq ka pranuar veprën penale nën III të kësaj aktakuze, mbajtja në pronësi kontrollë dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 p ar.1 të KP, kërkoj që trupi gjykues të vlerëson pranimin e fajësisë për këtë vepër penale nga se të mbrojturit tim arma e cila i është gjendur në posedim është i një tipi të vjetër dhe se e dyshimtë që ka qenë e aktive dhe funksionale, andaj me rastin e marrjes së vendimit të ketë parasysh këtë rrethanë.

Sa i përket veprës penale nën I të aktakuzës i mbrojturi im është akuzuar se e ka kryer veprën penale të dhunimit e cila është e sanksionuar në nenin 230 par.1 të KP ku thotë se kjo vepër si element qenësor kryesor ka detyrim për të kryer aktin seksual, në fakt nga dëgjimi i këtu të paraqiturës si të dëmtuar S.A. pa dyshim është vërtetuar koha

dhe vendi i kryerjes së aktit seksual që nënkupton kohën e frekuentimit të njerëzve në një Qendër tregtare siç ka qenë "...-..." vendin publik respektivisht tualetet e Qendrës tregtare "...-..." ku zakonisht frekuentojnë qytetarët dhe mysafirët e kësaj qendre tregtare e të cilët pa mëdyshje kishin për të vërejtur po të ishte bërë akti seksual me detyrim, dhunë, kërcënim respektivisht pa vullnet e dëshirë të dëmtuarës S.A. . Nga vet deklarimi i të dëmtuarës S.A. rezulton se e njëjta ka qenë në lidhje dashurie me të akuzuarin dhe se në kuadër të kësaj lidhje emocionale të tyre ka rezultuar se që ti kryejnë edhe këto marrëdhënie kuptohet me dëshirën vullnetin e këtu të dëmtuarës S.A. . Vet mënyra dhe forma e bërjes e kësaj marrëdhënie seksuale tregon se domosdoshmërisht është dashur që e dëmtuara të jetë aktive pa e shtyrë pa e kërcënuar dhe pa e detyruar për seks oral. Nga gjithë kjo mund të vijmë në përfundim se kohëzgjatja e aktit seksual mbi 40 minuta në tualetet e meshkujve tregon se kjo ka ndodhur me dëshirë dhe vullnet të saj, përndryshe duke patur parasysh strukturën e vet tualetit ku e dimë se ka qenë edhe afër frekuentimit të pikave të shitjes shumë lehtë e dëmtuara ka mund të kërkoj ndihmë me qëllim për të zbrapsur eventualisht qëllimin e të akuzuarit për akt seksual. Rrethanë tjetër që duhet të merret parasysh nga ana e këtij trupi gjykues është se marrëdhënia seksuale orale është kryer në mënyrë të dyanshme ndërmjet këtu të paraqitur S.A. dhe të akuzuarit, fakt tjetër për të treguar se e njëjta vullnetarisht i ka kryer këto marrëdhënie tregon se nuk është kjo e vetmja herë e cila ka ndodhur por se një gjë e tillë ka ndodhur dy herë ndërmjet të akuzuarit S.G. . Duhet të vlerësohet se e dëmtuara nuk është ndier e dëmtuar gjatë dhënies së deklaratës së saj, gjithsesi e mllëfosur dhe e egërsuar në të akuzuarin për mosrealizimin e premtimeve për fejesë e martesë e për të cilët nuk është ajo element i veprës penale. Andaj, kërkoj që gjykata duke i vlerësuar gjithë këto thëniet deklaratën e vet të dëmtuarës S.A. gjithsesi edhe deklaratën e të akuzuarit të vijë në përfundim se nuk kemi të bëjmë me veprë penale për të cilën e ngarkon aktakuza e prokurorisë. Përkritazi me këtë aktakuzë respektivisht nën I të dispozitivit prokuroria nuk ka arritur të fakton provat tjera që kishin për të vërtetuar se është kryer dhunimi aq më tepër kur nuk kemi prova nga ekzaminimet mjeko ligjore që kishin me vërtetuar shprehjen e dhunës ndaj të dëmtuarës S.A. .

Sa i përket pikës II të kësaj aktakuze mbrojtja konsideron se vepra penale e degradimit të integritetit seksual nga neni 233 par.1 të KP nuk është arritur të provohet e së pari për arsye të mos sigurimit dhe mos mundësisë së ballafaqimit me këtu të dëmtuarat e paraqitura në këtë aktakuzë. Gjykata ka arritur ti fton këtu të dëmtuarat D.T. , R.F. dhe A./Gj./P. të cilat në deklaratat e tyre të cilat janë dhënë para trupit gjykues dëshmitarja D.T. përshkruan njoftimin me këtu të akuzuarin por assesi nuk ka pasur dyshim dhe nuk ka akuzuar se i njëjti në veprimet tij ti ketë shkaktuar degradim të integritetit të saj në çfarë do qoftë forme, nga se vet ajo e pranon dhe deklaron se i akuzuari S.G. nuk ka kërkuar nga ajo që të ketë marrëdhënie seksuale gjithsesi nuk ka kërkuar fotografi apo diç tjetër nga ajo që të jetë lakuriq apo për të ndërmarrë ndonjë veprim te i akuzuari në drejtim të plotësisimit të epsheve të tija seksuale dhe nga kjo pa dyshim demantohet përshkrimi nën II i kësaj aktakuze ku thuhet se këtu i akuzuari ka kërkuar që e njëjta të zhvishet lakuriq dhe se i njëjti ka masturbuar duke shikuar të njëjtën të zhveshur në ambient të caktuar, nga kjo deklaratë kuptohet se vepra penale për të cilën dyshohet përkitazi me këtë të dëmtuar nuk është vërtetuar. Në vazhdim gjykata ka arrit të siguron edhe dy dëshmitaret tjera A./Gj./P. dhe R./B./F. të cilat në deklaratat e veta thojnë se janë fotografuar nga shoqja e tyre Sh.B. dhe se jo nga këtu i akuzuari i cili gjatë gjithë kohës gjer sa ato kanë qenë në katin e dytë i akuzuari ka qenë në katin e parë e që nga këto deklaratat lehet kuptohet dhe demantohet se këtu i akuzuari duke parë ato të zhveshura të ketë masturbuar apo diç tjetër nga se fizikisht një mundësi e tillë nuk ka ekzistuar ndërsa dera e dhomës së tyre ku është simuluar një fotografi e që në fakt

asnjëherë nuk është bërë atë ditë tregon se këtu i mbrojturi im nuk ka degraduar integritetin seksual të këtyre dy të dëmtuarave të paraqitura. Nga provat tjera të cilat janë administruar në fakt raportet e fotografit nuk është vërtetuar vepra penale nën I dhe II të kësaj aktakuze e që të njëjtat prova e nga të cilat kanë mund të vërtetuar vepra nën III të kësaj aktakuze. Duke i marr parasysh të gjithë deklarimeve të të dëmtuarave të paraqitura në fakt rezulton se nuk kemi të dëmtuara dhe nuk vërtetohet aktakuza e prokurorisë themelore në Prizren sa i përket veprës penale nën I. Kërkoj që gjykata duke pasur parasysh gjithë këto që u tha gjatë marrjes së vendimit lidhur në veprën nën III të kësaj aktakuze ti merr për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese se i njëjti është baba i martuar, familjar dhe për veprimet e ndërmarra të tij të papërgjegjshme duke shfrytëzuar aftësitë e veta për kontakt me të dëmtuarat është penduar.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 KP-së, ndërsa nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale dhunimi nga neni 230 par. 1 të KP dhe veprës penale degradimi i integritetit seksual nga neni 374 par.1 të KP-së.

Gjykata në shqyrtimet kryesore publike, nuk ka administruar prova sa i përket veprës penale nga neni 374 par.1 të KP-së për shkak se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ndërsa për veprat tjera penale i ka nxjerrë të gjitha provat e propozuara të nevojshme dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave në tërësi, është vërtetuar kjo gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari gjatë vitit 2013 në vazhdimësi deri me datë 21.01.2014 në Prizren me dashje për ti bindur me anë të premtimit të rremë dhe mashtrimit, i cët (nxit) personat tjerë të gjinisë femërore ti ekspozojnë pjesët intime të trupit, të masturbojnë dhe kryejnë akt seksual, me qëllim për ti kënaqur epsheet e veta pa pëlqim dhe vullnet të tyre, në atë mënyrë që prezantohet si zyrtar i një Shoqate Humanitare Ndërkombëtare nga Prishtina, kinse do të dërgon familje të varfër në shtetin e Evropës si në Austri, Belgjik, Danimarkë, Kanada Amerikë etj, që ti punësoj nëpër shtëpi të pleqve, ashtu që pasi bie në kontakt me të dëmtuarat Sh.B. , A.P. dhe R.F. , me të cilat më pas takohet disa herë me to duke ju thënë se paraprakisht duhet ti plotësojnë disa kushte të kërkuar, të cilat janë : të zhvishen lakuriq, ti fotografojë dhe kontrollojë të zhveshura se si duken në trup, deri sa të dëmtuarën Sh.B. së bashku me dy shoqet e saj A.P. dhe R.F. , i dërgon në objektin e firmës “...” i fut në një dhomë që të zhvishen lakuriq, i fotografon me aparat dhe më pas përmes një gypi të plastikës i shikon të zhveshura duke i ekspozuar pjesët intime të trupit.

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari me datë 21.01.2014 rreth orës 15:00 në fshatin , komuna e Dragashit, me rastin e kontrollit të kryer nga policia në shtëpinë e tij, i janë gjetur armë të zjarrit dhe atë : një pushkë automatike e modelit “Type 68” kalibër 7.62 x 93 mm me nr.serik 101122013, 15 (pesëmbëdhjetë) copë fishek –municion të kalibrit 7.62 x 39 mm, 2 (dy) karikator të zbrazur të dizajnuar për pushkë automatike të tipit AK-47, një karikator të zbrazur për fishekë të kalibrit 7.62 x 39 mm të dizajnuar për pushkë automatike “Type-69”, 1 (një) pushkë me veprim me shule e model “carcano fat-41” e kal.6.5 x 53 mm, me nr.serik 24321 si dhe 30 (tridhjetë) copë fishek-municion e kal. 65 mm “Carcano” që të gjitha funksionale, të cilat mbante në pronësi dhe përdorim të pa autorizuar dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët.

I akuzuari S.G. sikurse në deklaratën e tij të dhënë para prokurorit të shtetit ashtu edhe gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se me S.A. kishte

pasur lidhje serioze, me të ëhtë njoftuar pasi që vet S.A. e kishte thirre në telefon, më pas kishin filluar të dalin bashkë shumicën e herave në Marash shpesh herë edhe në "...-..", me të kishte pasur një dashuri reale dhe atë me vet vullnetin e saj. Në "...-.." kishte pasur marrëdhënie seksuale orale me te, akti seksual kishte ndodhur në katin e parë në banjë të meshkujve, S.A. nuk e kishte kërcënuar, por atë ditë kishin ngrënë picë, kishin pirë kafe dhe S.A. e kishte përcaktuar që të shkojnë në banjo-tualet të meshkujve, i akuzuari i pari ndërsa ajo të shkoj pas tij, ku gjysmë ore kishin kryer aktin seksual oral, një herë kishin pasur marrëdhënie seksuale orale të dyanshme dhe një herë të njëanshme nga S.A. , me vete dëshirën e saj pa e kërcënuar asnjëherë. Kjo ishte hera e dytë që kishin pasur akt seksual, hera e parë kishte në "...-.." në banjot e meshkujve që ishin afër "...-.." kjo kishte ndodhë dy javë para këtij rasti, atë dit fillimisht kishin qenë duke pirë kafe në restorantin "....." te Qylhani ku i akuzuari kishte pasur dëshirë të shkoj në hotel por S.A. nuk kishte pranuar dhe i kishte thënë se pranon të shkoj vetëm në "...-.." për të bërë seks oral. Edhe pse i akuzuari kishte kërkuar të ketë marrëdhënie seksuale deri sa kishin qenë tek restoranti "....." e njëjta nuk kishte pranuar dhe kishte kërkuar të shkojnë në "...-..", për këtë marrëdhënie nuk i kishte dhënë asnjë shpërblim, ku kishin qëndruar 25 minuta në banjo të "...-..-..". Edhe para këtyre dy akteve kishin pasur afërsi fizike sa herë që kishte pasur dëshirë i akuzuari, puthjet po ashtu i kishte bërë me vetë dëshirë. Nëna e S.A. kishte pasur njohuri për lidhjen e dashurisë, ku dhe i akuzuari ishte takuar dhe kishte pirë kafe në ".....". Përveç këtyre dy rasteve nuk kishin pasur më marrëdhënie seksuale vetëm kishin biseduar me telefon dhe ishin takuar. Lidhja e tyre kishte përfunduar kur S.A. i kishte thënë se vëllau i vet e kishte kuptuar dhe nuk po e len më S.A. që të del. Në vazhdim ka shtuar se me S.A. ishte takuar vetëm për lidhje dashurie ku për herë të parë nuk ishte prezantuar se kush ishte ndërsa për herë të dytë i kishte treguar se ku punon, që ishte i martuar dhe kishte fëmijë, S.A. i kishte thënë se nëse kishte pasur mundësi të martohen dhe të ikin jashtë vendit ndërsa në Kosovë jo, pasi që ajo kishte qenë e fejuar. Nuk i kujtohet të akuzuarit por ndoshta kishte pasur mundësi që i ka thënë se do ti tregoj burrit ë asaj kur të martohet se ka pasur lidhje me të, qëllimi i tij ishte që të frikësoj S.A. që të del ajo përsëri pasi që kishte thënë se nuk do të del më. Pas marrëdhënies të fundit seksuale orale me S.A. kishte kërkuar përsëri të takohet ishin takuar 20 min në "...-.." dhe kishin pasur vetëm puthje. I akuzuari i kishte thënë S.A. se punon në Austri pasi që ajo i kishte thënë të thotë këtë gjë sa herë që e thërret në telefon në mënyrë që të dëgjoj familja e saj.

Ndërsa me Sh.B. vetëm kishte biseduar në telefon afër 6-7 muaj, e cila kishte pasur problem me burrin e vet dhe i kishte thënë të akuzuarit se kishte pas qejf të takohet me të dhe të ikin jashtë dakun, i akuzuari me burrin e Sh.B. , M. kishte kontaktuar dhe i kishte thënë fjalët e Sh.B. se gjoja do të i qes jashtë, sepse M. ia kishte gjetur mesazhet Sh.B. që i kishte shkëmbyer me të akuzuarin. Në mesazhe i kishte thënë se do të ia plotësonte çdo dëshirë të akuzuarit veç të ik jashtë vendit me fëmijë dhe me bashkëshortin. Sh.B., R.F. e kishte pas motër të burrit nuk e dinte se çka e ka pasur A.P., i akuzuari me Sh.B. ishte takuar tre herë, dy herët e para ishin takuar vetëm me Sh.B. ku kishin dal kishin pirë kafe dhe kishin pasur veç puthje me të kishte pasur lidhje dashurije, herën e dytë ishte takuar në stacionin e autobusëve nuk ka pasur asgjë tjetër mes tyre, por herën e tretë në Prizren kishte ardhur bashkë me R.F. dhe A.P. e cila ide kishte qenë e Sh.B. , arsyeja e ardhjes në Prizren kishte qenë se gjoja të i mbulojnë mesazhet e Sh.B. dhe vetë të akuzuarit. Së bashku me Sh.B. , R.F. dhe A.P. kishin shkuar në një shtëpi për tu fotografuar të zhveshura me rroba të brendshme, ato kinse i kishte fotografuar Sh.B. me një digitron të televizorit të cilin i akuzuari ia kishte dhënë Sh.B. , gjoja për tu fotografuar e që nuk ishin fotografuar fare pasi që kishte qenë digitron. I akuzuari gjatë fotografimit kishte qëndruar në katin e parë të asaj shtëpie dhe

nuk kishte kërkuar nga ato që të zhvishen para tij. D.T. e kishte njohur përmes një taksisti gjoja i akuzuari të qetë jashtë Kosovës, prej të cilës nuk ka kërkuar asgjë as të zhvishet lakuriç, as të ketë marrëdhënie seksuale me të, as të mastruboj para tij, as nuk ka fotografuar lakuriç. H.K.1 nuk i kujtohet ndërsa Gj.Sh. e njihte me burrin e saj dhe atë kishin dalë për të pirë kafe, asnjëra nuk i kishte dhënë vullnetarisht ndonjë para as Sh. B. , i akuzuari ka shtuar se Sh.B. vet e kishte thirrë në telefon me H.K.1 dhe D.T. është njoftuar përmes taksistit Sh. , Gj.Sh. përmes D.T. ndërsa A.P. dhe R.F. përmes Sh.B. . Me të cilat ishte takuar në prezencën e burrave të tyre qëllimi i tij kishte qenë vetëm të ri të pi kafe me ato, burri i Sh.B. , M. e kishte telefonuar të akuzuarin dhe i akuzuari i kishte thënë që të vinë në Prizren, këtë e kishte bërë për të ia mbuluar mesazhet e Sh.B. që ia kishte zënë burri i vet. Dhe ishin takuar në stacionin e autobusëve ku kishin biseduar gjoja se i akuzuari do ti dërgoj jashtë dhe do të i punësoj te dom i pleqve ku dhe ishte prezentuar me emrin A. . Për të cilat femra nuk kishte ditur se në çfarë gjendje ekonomike janë pasi që ishin takuar me Sh.B. , A.P. dhe R.F. kishin shkuar në firmën “....” ku i akuzuari kishte punuar si vullkanizer me kërkesën e Sh.B. për të i fotografuar ato me kusht që të ishin të shëndosha dhe jo të operuara. Në atë vend kishin shkuarës bashku me kerr kishin hyrë mbrenda në atë shtëpi ato kishin shkuar në katin e dytë Sh.B. ia kishte dhënë digitronin për ti fotografuar pasi që i kishte thënë atyre Sh.B. se duhet të fotografohen. Ndërsa ai vet kishte qëndruar në katin e par. Qëllimi i të akuzuarit nuk kishte qenë të i shohë të zhveshura ato por vetëm të ri me atë dhe të pi kafe sepse nuk kishte pasur ditën se çka të bëj, të cilat femra nuk i kishte mashtruar sepse edhe burrat e atyre e kishin ditë, që edhe i akuzuari ishte duke shkuar së bashku me atë, por që do i fotografoj Sh.B. , pasi që kishin dalur nga dhoma me kerr i kishte kthyer përsëri në stacion të autobusëve dhe nga ajo ditë më nuk ishte takuar me asnjërin. Shton se me S.A. ishte takuar në “.....” në kohën e drekës kur punëtorët hajnë drek, dhe se S.A. i kishte prishur raportet me të fejuarin para një viti pasi që ishte takuar me të akuzuarin, ndërsa me Sh.B. kishte pasur marrëdhënie dashurie me të cilën nuk kishte pasur marrëdhënie seksuale, shton se është i martuar një her në vitin 1991 dhe se kur kishte dalë me S.A. ka qenë i martuar.

Per vertetimin e gjendje faktike gjykata ka ndegjuar deshmitaret-te demtuarat, S.A. , D.T. , A.P. , R.F. dhe ka lexuar deshmitet e deshmitareve H.K.1 , Gj.Sh. , Sh. B. , githashtu ka administruar edhe provat materiale dhe ate: ka bere leximin e transkripteve te kominikime telefonike dhe elektronike, ka lexuar njoftimin e policise per hyrje daljet dhe SMS si dhe ka lexuar raportin e ekspertizes laboratorike per ekzaminimin e kompjuterive AKF. - ... te dates 06.04.2014 se bashku me CD.

Gjykata nuk i ka administruar provat te cilat kane qene te nderlidhura me vepren penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 KP-së pasi qe i akuzuari e ka pranuar fajësinë për këtë vepër penale.

E dëmtuara –dëshmitarja S.A. sikurse në deklaratën e saj të dhënë para prokurorit të shtetit ashtu edhe gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor ka deklaruar se të akuzuarin e njeh përmes një tezaku të saj, i akuzuari kishte punuar në pompë të benzinës në lagjen , i cili i kishte thënë tezaku të saj se kinse i duhet një femër për fejesë për një familjar të tij, i akuzuari ia kishte dhënë numrin e tij tezaku, i cili këtë numër ia kishte dhënë të dëmtuarës, e cila ia kishte cingëruar të akuzuarit i cili më pas e ka thirrë në telefon ku dhe kishin biseduar, takimi i parë me të akuzuarin kishte qenë te Mulliri ku së bashku me motrën e dëmtuara ishin takuar dhe kishin biseduar, i akuzuari ishte paraqitur me emrin A.H. nga fshati apo nuk i kujtohej, përsëri ishte takuar me të akuzuarin në

prezencën e motrës dhe nënës së vetë, me nënën kur kishte qenë me të akuzuarin jan takuar në lagjen Ortakoll në , ku kishin biseduar rreth bisedave familjare, përsëri ishin takuar në ...-. e shoqëruar me vajzën e tezës, si dhe një ditë ishte takuar e vetme me të akuzuarin në ...-. ku së pari kishin pirë kafe dhe më pas kishin shkuar në tualet, ku i akuzuari kishte tentuar të kishte marrëdhënie seksuale por e dëmtuara nuk kishte pranuar pasi që ende nuk ishte e fejuar me të dhe nuk bën asgjë me të, po të njëjtën ditë i akuzuari kishte kërkuar që të bëj seks oral ku pa dëshirë kishte pasur seks oral me të akuzuarin duke theksuar se ma mire te kete mardhenjes seksuale orale se sa maredhenje seksuale normale duke shtuar se i kishte premtuar se do të fejohen dhe i kishte premtuar se do të jetojnë në Austri dhe i kishte thënë se vet ai jeton në Austri per kete kishte pranuar të bëj seks oral duke besuar se do të martohen. Po ashtu i akuzuari i kishte thënë se do të ia qet fotot në facebook, por e dëmtuara nuk kishte dijeni se çfarë fotot pasi ajo nuk kishte bërë foto me të dhe nuk ishte në dijeninë se fshehtas kishte bërë ndonjë foto gjatë aktit seksual, pas këtij rasti shumë herë i kishte telefonuar por e njëjta nuk ia kishte qelë telefonin. Pas aktit seksual e dëmtuar e kishte kuptuar se i akuzuari ishte mashtrues pasi që e thërret prej Kosovës - numrit të valës dhe i thotë se është në Austri. Pas kësaj asnjëherë më nuk e kishte hapur telefonin, nuk e dinte se rastin në polici kush e kishte lajmëruar.

Ne vazhdim ka deklaruar se me te akuzuarin eshte takuar tek restorani “.....” dhe ka menduar se është personi me te cilin ka mundësi te fejohet, ai eshte prezentuar si A.H. nga , jeton me baben dhe nenen ne Austri, punon atje dhe se ka deshire mu njoftu me një vajze me u feju me te, me pase nje jete normale, se i ka 39 vjet, per qka edhe disa here e ka pyetur se mos është i martuar. E demtuara ka deklaruar se nuk ka qene e dashuruar ne kete person edhe pse ne deklaraten e saj ne polici ka deklaraur se me te ka pasur lidhje dashurije por se nuk ka pasur ndjenja te forta dashurije per te. E gjithë kjo lidhje kishte zgjatur nga muaji gusht deri me daten 25 tetor. Gjate kesaj kohe kishin pasur edhe puthje dhe ledhatime dhe ate sa here qe jane takur te vetem kane pasur puthje, hera e pare ka qene tek Marashi po ashtu edhe ne vende tjera si ne ambeltore te tregu i gjelbert. E demtuara ka deklaruar se nuk kan pasur marredhenje seksuale me te akuzuarin, ndersa vetem nje here kane pasur marredhenje seksuale orale ne ...-. . Ate dite ka qene me te akuzuarin te ulur ne restoran ne ...-. , ka pasur edhe njerëz te tjerë aty, kane qendruar nje ore para se te shkojne ne toalet, gjate asaj kohe nuk kane pasur puthje pasi qe ka pasur edhe njerez te tjere aty, i akuzuari i kishte kerkuar qe te shkonin ne toalet per te kryer marredhanje seksuale, fillimisht i kishte thene per puthje pastaj gjate puthjeve ka kerkuar te kene marredhanjes seksuale normale por e demtuara nuk e kishte lejuar nje gje te tille pastaj e kishte detyruar te kene seks oral duke e detyruar me fjale dhe me dhune duke i thene se do ti publikoj fotografite ne facebook, por nuk e dinte se qfar fotografi pasi qe e demtuara nuk ishte zhveshur qe ai ta fotografonte, nuk ka ndodhur qe i akuzuari te kete bere fotografi deri sa kane qene bashke, por se ka mundur qe “tinza” ku fytyren e te demtuares me trupin e dikujt tjeter ta postoj ne facebook. E demtuara ne vazdim ka theksuar se ajo ishte e ulur ne guacen e toaletit, nuk ka qene e zhveshur ndersa i akuzuari i ka pasur te zhveshur pantollonat, akti seksual oral ka zgjatur 20 minuta, i akuzuari ka perfunduar dhe ejakulimin e ka bere jashte. E demtuara ka deklaruar se gjate aktit seksual e ka perdorur doren e saj, e gjate aktit ka ndegjuar zhurma te njerzve te cilet dy tri here kane trokitur ne deren e toaletit, e njejta nuk kishte kerkuar ndihme. Gjate aktit seksual nuk kishte pesuar ndonje lendim nga i akuzuari, dhe se kete akt seksual nuk e kishte bere me deshire por se nuk e kishte lajmeruar policine, pas perfundimit te atit seksual e demtuara kishte shkuar tek motra e saj, pas ketij rasti me te akuzuarin ishte takuar edhe nje here per ta skjaruar muhabetin dhe me vendos per fejese, i akuzuari i kishte telefonuar dhe i kishte thene se po shkon ne Austri, e demtuara kishte dale per ta pershendetur dhe e njejta nuk ishte friguar se do ta le dhe nuk do ta fejoj, ky ka qene takimi i fundit dhe ka

ndodhur tek ... ku i akuzuari e kishte pershendetur se po shkon ne Austri dhe i kishte thene se kur te kthehet nga Austria do te fejohen.

Ate dite ne ...-.. i akuzuari ka ecur perpara ndersa e demtuara ka shkuar pas tij, i akuzuari i kishte thene eja prapa meje dhe e demtuara kishte shkuar, e demtuara ka deshmuar se ka qene e imponuar qe te shkon pas tij, tere kohen i kishte thene se po te pres me shku atje dhe e demtuara ka shkuar, pra nuk ka shkuar edhe shum me pelqim, ka qene pak e pajtimit nuk e ka bere komplet me pelqimin e saj por nga friga nga shantazhet prej te akuzuarit, ka qene e friguar, e demtuara ka deklaruar se ka mundur qe te mos shkoj ne toalet, por ka shkuar se i akuzuari tan kohen e kishte thirre qe te shkonte prandaj edhe ka shkuar, nga toaleti e para kishte dale e demtuara, ne vazhdim e demtuara ka deklaruar se me te akuzuarin kishin qene edhe te restorani “” te Qylhani ku i akuzuari kishte kerkuar qe te kene marrdhenje seksuale por e akuzuara nuk ka pranuar. E demtuara ka theksuar se para se te shkonte ne toaletin e ...-.. kishin biseduar rreth fejeses dhe rreth rregullimit te letrave per te shkuar ne austri, ate dite i akuzuari nuk i kishte thene se do ta nxjerr foto ne facebook, mirepo keto fjale ia kishte thene pas ketij rasti, ne vazhdim ka deklaruar se ka qene e mashtruar pasi qe ate dite kur kane pasur marredhanje tere kohen i akuzuari i kishte thene te shkoj ne banjo prandaj edhe ka shkuar, e demtuara e kishte kundërshtur te akuzuarin duke i thene se ka shume njerez qysh me shku, ndersa me ndonje veprim nuk e kishte kundërshtuar, ndersa nuk ishte larguar nga ...-.. para se te shkonte ne toalet per shkak se ishte friguar, ndersa ne fund ka deklaruar se nuk parashtron kerkese pasurore juridike.

Gjykata pjeserisht ia fali besimin deklarates se deshmitares S.A., ne te vertetet deshmitarja-e demtuara gjate deshmise se saj e ka pershkruar ne teresi rastin perveqse ka qene kunderthanes me veteveten kjo per faktin se e njejta fillimisht deklaroi se *i akuzuari i kishte kerkuar qe te shkonin ne toalet per te kryer marredhanje seksuale, fillimisht i kishte thene per puthje pastaj gjate puthjeve ka kerkuar te kene marredhanjes seksuale normale por e demtuara nuk e kishte lejuar nje gje te tille pastaj e kishte detyruar te kene seks oral duke e detyruar me fjale dhe me dhune duke i thene se do ti publikoj fotografite ne facebook, por nuk e dinte se qfar fotografi pasi qe e demtuara nuk ishte zhveshur qe ai ta fotografonte, nuk ka ndodhur qe i akuzuari te kete bere fotografi deri sa kane qene bashke, por se ka mundur qe “tinza” ku fytyren e te demtuares me trupin e dikujt tjeter ta postoj ne facebook.* Ndersa ne deshmine e saj gjithashtu deklaroi se *ate dite i akuzuari nuk i kishte thene se do ta nxjerr foto ne facebook, mirepo keto fjale ia kishte thene pas ketij rasti, ndersa nuk e pershkruar kurrfar veprimi te dhunes te kryer nga i akuzuari.*

Ne vazhdim te deshmise se saj ajo deklaroi se *ate dite ne benaf i akuzuari ka ecur perpara ndersa e demtuara ka shkuar pas tij, i akuzuari i kishte thene eja prapa meje dhe e demtuara kishte shkuar, e demtuara ka deshmuar se ka qene e imponuar qe te shkon pas tij, tere kohen i kishte thene se po te pres me shku atje dhe e demtuara ka shkuar, pra nuk ka shkuar edhe shum me pelqim, ka qene pak e pajtimit nuk e ka bere komplet me pelqimin e saj por nga friga nga shantazhet prej te akuzuarit, ka qene e friguar.*

E demtuara ka deklaruar se nuk ka shkuar ne toalet edhe me shum pelqim, ka qen pak e pajtimit nuk e ka bere komplet me pelqimin e saj por nga friga, ndersa nga ana tjeter ka deklaruar se *ka mundur qe te mos shkoj ne toalet, por ka shkuar se i akuzuari tan kohen e kishte thirre qe te shkonte prandaj edhe ka shkuar, pra e demtuara nuk pershkruan se si ka qene e imponur dhe si ka qene e friguar.*

Ne deshmime e saj deshmitarja fillimisht ka deklaruar se *pas aktit seksual e dëmtuar e kishte kuptuar se i akuzuari ishte mashtrues pasi që e thërret prej Kosovës - numrit të valës dhe i thotë se është në Austri. Pas kësaj asnjëherë më nuk e kishte hapur telefonin ndersa ne vazhdim te deshmise se saj ka deklaruar se i akuzuari i kishte telefonuar dhe i kishte thene se po shkon ne Austri, e demtuara kishte dale per ta pershendetur dhe e njejta nuk ishte friguar se do ta le dhe nuk do ta fejoj, ky ka qene takimi i fundit dhe ka ndodhur tek*

Deshmitarja D.T. sikurse ne deshmime e saj ne prokurori ashtu edhe gjate shqyrtimit kryesore ka deklaruar se te akuzuarin e njeheres permes nje familjari te burrit te motres se saj te cilet se bashku kishin ardhur ne shtepine e deshmitares dhe kishin biseduar rreth daljes jashte vendit deshmitarja dhe djali i saj, nen kushtet qe e njejta te vishet ma shkurt, ma moderne sepse ashtu e lyp vendi, te punoj ne shtepi te pleqve, i akuzuari i kishte kerkuar qe te shkonte te bente nje kontroll nje shtepi afer por e njejta nuk kishte pranuar duke i thene se mund te vij vetem ne ambulante per te bere kontroll. Ne vazhdim ka shtuar se i ka thene se duhet te zhvishet lakuriq qe ti fotografonte qe ta shohin ata jasht se qfar trupi kishte, ndersa nuk i kishte kerkuar qe te kete mrrredhenje seksuale me te gjithashtu nuk i kishte kerkuar as te holla e as dokumente te caktuara, duke shtuar se i akuzuari vete nje here e kishte telefonuar dhe i kisht thene se a do te vjen ndersa deshmitarja i eshte pergjigjur se jo dhe asnje here tjeter nuk e kishte thre.

Gjykata ia fali besimin deklarates se deshmitares D.T. dhe nga kjo deklarate eshte vertetuar se e njejta ishte takuar me te akuzuarin ne shtepine e saj ku kishin biseduar rreth daljes jashte vendit te deshmitares dhe djalit te saj. I akuzuari ia kishte treguar kushtet te cilat duhet ti permbushe deshmitarja per shkuarjen jashte vendit per qka e njejta nuk kishte pranuar, ndersa qe te kete mrrredhenje seksuale nuk i ka kerkuar i akuzuari, me te akuzuarin vetem kete here ishte takuar asnje here tjeter.

E demtuara R.F. gjate shqyrtimit kryesore ka deklaruar se te akuzuarin e ka takuar ne Prizren por i njejti eshte paraqitur me emrin A. te njejtin e ka identifikuar edhe gjate shqyrtimit kryesore, me te eshte njohur permes shoqes se saj R.F. e cila i kishte thene se vellau i saj permes shoqeve te tij ka ndegjuar se nje person A. po qet familje jasht vendit pasi qe po kerkojne punetor per te punuar ne shtepi te pleqve, i kishte thene se po kerkohen familje te varfera, keshtu qe se bashku kishin ardhur ne Prizren deshmitarja me burrin e saj, shoqja e saj R.F. me vellaun e saj ishin takuar ne nje kafiteri tek stacioni i autobusave ku ne prezencen e burrit te saj kishin biseduar, i akuzuari ia kishte kerkuar qertifikatat e lindjes, i kishte marre deshmitaren R.F. dhe Sh.B. me veturen e tij dhe i kishte derguar ne nje shtepi aty ua kishte kerkuar urinen dhe i ka fotografu, pas kesaj ishin kthyer ne stacionin e autobusave dhe ishin kthyer ne shtepi. Ne ate shtepi e kishin dhene urinen dhe ishin fotografuar me rroba te brendshme, i kishin fotografuar me nje mjet i cili nuk ishte telefon. Ne ate shtepi kishin shkuar deshmitarja, R.F. dhe Sh.B. e cila i kishte fotografuar pasi qe keto nuk kishin lejuar qe i akuzuari ti fotografonte me rroba te brendshme me brek e jelek e ter kjo kishte ndodhur diku 20 apo 25 minuta, i akuzuari u kishte thene se duet te fotografohet qe te shikohet mos kane ndonje operacion ne trup apo ndonje shenje dhe keto fotografi me i qu jashte per te verifiku mos kan ndonje operacion, gjithashtu i akuzuari i kishte thene ti nenshkruajne disa letra te bardha qe te dihet se e kujt eshte urina, ne vazhdim ka shtuar se i akuzuari nuk i ka pa te zhveshura perveq nese i ka pa fotot pasi qe ai nuk ishte brenda ne dhome derisa shoqja e saj Sh.B. i kishte fotografuar, ndersa kur eshte fotografuar Sh.B. ajo kishte hyre me te akuzuarin ne nje dhome, gjate kesaj kohe bashkeshorti i deshmitares kishte qendruar ne stacionin e

autobuseve. Ne vazhdim ka theksuar se mjeti me te cilin ishin fotografuar ishte i shkurte i holle si dylbi dhe nuk kishte pare nese eshte nxjerre ndonje fotografi e as qe i eshte derguar ndonjeheren dhe nuk kan para asnjehere ndonje fotografi, duke shtuar se i akuzuari nuk i kishte kerkuar qe te kishin marredhanje seksuale me to as nuk i kishte kerkuar qe te masturbonin, ne fund ka shtuar se nuk parashtron kerkese pasurore juridike.

Deshmitarja R.F. gjate shqyrtimit kryesore ka deklaruar se te akuzuarin e njeh me emrin A. te njejtin e kishte njohur para tri viteve, me te eshte takuar ne Prizren te stacioni e Autobusave ku prezent ishin edhe shoqja e saj A.P., kunata Sh.B. , vellau i saj M. dhe burri i A.P., A.P. . I akuzuari e kishte thirre vellaun e saj M. prandaj edhe kan shkuar prej Mitrovice ne Prizren ku edhe ishin takuar kishin biseduar qe te dilnin jasht per te punuar, i akuzuar i kishte thene se do te shkoni jasht Kosove me i pastru, ruajt pleqt ne shtepi te pleqve, i ishte thene se duhet fotokopja e leternjoftimit, qertifikata e lindjes dhe me shku me i dhane analizat, ku edhe kan shkuar ne nje shtepi ku nuk ishte askush, ka qene nje vullkanizer posht shtepie nalt ishte nje dhome, ka pas nje banjo, aty e kane kryer urinen per ti kryer analizat gjoja per mos me pas operacione ne trup iu ka ba edhe foto te cilat i kishte bere Sh.B. ndersa i akuzuari kishte qendruar jashte dhomes, foto i kishte bere me nje instrument i cili nuk dukej si aparat dhe nuk ka shkreper si aparat por dukej si digitron i televizorit, Sh.B. e kishte mesuar i akuzuari se si te fotografonte, por foto asnjehere nuk kishin pa. Para se ti benin foto i akuzuari i kishte kerkuar qe tua shoh trupin te zhveshur por nuk kishin pranuar, ai i kishte kerkuar qe foto ti benin me rreoba te brendshme, ndersa nuk i kishte kerkuar qe te kene marredhenje seksuale e as te masturbonin. Ne ate shtepi kishin qendruar perafersishte gjysme ore gjate kohes sa ishin fotografuar ne dhome ishte dhe A.P. sepse ishin friguar, ndersa Sh.B. ishte fotografuar para tyre, pastaj kishin biseduar rreth temes se daljes jashte vendit, por se nje gje e tille kurr nuk kishte ndodhur dhe e kishin kuptuar se ishte mashtrim. Per ardhjen ne Prizren i kishin bindur fjalet e te akuzuarit te cilit deshmitarja i referohet si A. , qe te dilnin jashte vendit, me te akuzuarin edhe deshmitaja nje here personalisht kishte biseduar ne telefon rreth daljes jashte vendit ku e kishte pyetur se a duhen para ndersa i akuzuari i kishte thene se nuk duhen sepse e ka motren jasht duke punuar ne shtepi te pleqve, ai u kishte premtuar se me te do te udhetonin edhe bashkeshorti i saj dhe femijet.

Gjate shqyrtimit kryesore gjykata ne pamundesi te sigurimit te prezences se te deshmitares Sh.B. e cila kishte pesuar aksident trafiku dhe nuk mund te paraqitej ne gjykate ka lexuar deshmine saj te dhene ne polici si dhe ne pamundesi te sigurimit te przences se deshmitarve H.K.1 dhe Gj.Sh. per shkak te adreses ka lexuar deshmite e tyre te dhena ne prokurori perkatesisht ne polici.

Dëshmitarja H.K.1 ne dëshminë e saj ka deklaruar se para vitit 2014 burri i saj G.K. e kishte njoftuar se ishte takuar me një person i cili quhet S. i cili i kishte thënë se a është i interesuar me dal jasht me punu, se ai ka mundesi qe ti dergoj vetem femrat ato te cilat jane te gjendjes se varfer. I akuzuari i kishte thene se duhet personalisht te bisedoj me bashkeshorten, per çka deshmitarja kishte biseduar me te akuzuarin, i cili i kishte thene se a je ne gjendje me punuar me pleq sepse atje ne Kanada duhet me i pastru pleqt, a e ke burrin gjeloz se duhet me punuar edhe me meshkuj dhe nuk ban ti tregosh burrit nese vonohesh nga puna se ke pun me meshkuj gjithashtu i kishte thene se para se me shku jasht duhet me shku ne Prishtinë vetem pa burrin, ne nje shtepi te pleqve me te inqizuar si po i lan pleqt dhe pastaj duhet me te qit ne internet dhe me i pa ai i madhi ne Kanada si po i lan pleqt, pastaj se ka me ardhë nje doktorr me kontrolluar mos ka ndonje shenje, ndonje operacion, mos ke nerva apo mos ke ndonje semundje ne zemer, dhe duhet te zhveshet lakuriq, deshmitarja nuk i kishte pranuar keto kushte. Para dhe dokumentnte

nuk i kishte kërkuar, përveq se i kishte thënë se janë tri shtete Kanada, Belgjika dhe Amerika prej këtyre shteteve në cilën të bjen shorti bashkë kan me shku pasi që edhe i akuzuari me familje kishte me shku. Me te akuzuarin ishin takuar se bashku me burrin e saj ne Prizren afer parkut te qytetit, ku i akuzuari e kishte ndare nga burri dhe i kishte permendur kushtet e lartepemendura, gjithashtu i kishte thene se nese nuk behet qe ne Prishtine me qendruje nje jave me e la-pastru nje plak ateher duhet ta bëje ne Prizren dhe per kete duhet te lajmerohet tek i akuzuari. Deshmitarja ka shtuar se i akuzuari ia kishte dhene burrit te saj nje numer te telefonit duke i thene se eshte numri i nje shoku A. nga Prishtina me te cilin duhet me bisedu gjeresisht sepse ai eshte kryesori dhe prej tij varet se a ju pranon me shku ne Kanada, kur kanë biseduar me telefon me këtë A. ai i kishte thënë se me te nuk mund të takohen, vetëm në fund kur kryhet puna do të shihen bashkë.

Deshmitarja Gj.Sh. ne deshmime e saj ka deshmuar se vjehrra e saj e kishte informuar se tek fqinjët ka ndegjuar se nje person po qitka jashte shtetit, per qka deshmitarja ka shkuar dhe ka biseduar me fqinjët e saj dhe kane vendosur qe te shonin jashte shtetit. Nje dite i akuzuari kishte ardhë tek fqinjët dhe kishte shkuar qe te bisedonte me te akuzuarin. I akuzuari i kishte terguar kushtet per te shkuar ne Belgjik Danimark dhe Kanada, deshmitares i kishte thene se eshte shum e re dhe se a mundesh me krye kete pune me ua nderru pampersat pleqve deshmitarja kishte pranuar duke i than se i ka kushtet e randa, i akuzuari ia kishte dhene nje numer telefoni te nje personi ne Prishtine qe te bisedonte me te. Deshmitarja ka shtuar se ka biseduar me personin nga Prishtina te cilit ia kishte treguar te gjithë situaten dhe i kishte thene qe te bisedonte prap me sametin. Pas disa dite i akuzuari kishte ardhë prap te fqinjët dhe ia kishte dhene te gjitha te dhanat e familjes, dhe nga ajo ditë qdo dite i kishte telefonuar he kishin bisuar rreth shkuarjes jasht vendit. Deshmitarja ka shtuat se i akuzuari i kishte kerkuar qe te shkonte ne nje hotel se bashku me te qe tia bente nje kontrollë gjinekologjike gjoja tia bente nje analize se mos eshte e infektuar apo e semure, deshmitarja i kishte thene se pse i akuzuari tia bante kete kontroll, i kishte thene se do te shkonte tek gjinekologu ta bej testin dhe raportin do tia dergonte te akuzuarit po i njejt i kishte thene se nuk ban ashtu sepse nuk besojne ata jashte vendit sepse ata duhet me te pa live permes internetit, gjithashtu i kishte thene se duhet ta laj-pastroj te akuzuarin se si e bene deshmitarja kete pune live permes internetit qe ta shohin personat jashte shtetit ne Danimarkë, Belgjike dhe Kanada, gjithashtu i kishte thene se duhet ta prekte vaginen dhe gjate prekjes duhet ta kryej dhe pasi qe ta kryen ateher ai e merr spermen dhe e ban analizen ku te gjitha kan me u ba permes internetit me kamer per me vertetu ata personat jashte, duke i thene se nese nuk e bene nuk mundet me shku jashte ndersa deshmitarja i kishte thene qe ta lene krejt kete pune. I akuzuari nuk i kishte kerkuar para per te shkuar jashte vetem i kishte kerkuar qe te mbesin shoke.

Duke analizuar dëshmitë e dëshmitareve H.K.1 dhe Gj.Sh. në tërësi ua fali besimin këtyre deklaratave dhe nga këto deklarata gjykata kla vërtetuar se i akuzuari i ka kontaktuar dhe takuar me dëshmitaret duke u ofruar mundësinë që të dalin jashtë vendit dhe atë kryesisht femrat për të punuar në dom-shtëpi të pleqve duke u përcaktuar edhe kushtet të cilat duhet ti plotësojnë dhe atë se duhet të bëjnë nje kontrollë gjinekologjike gjoja tia bente nje analize se mos janë të infektuar apo të semura, gjithashtu i kishte thene se duhet ta laj-pastrojnë te akuzuarin se si e bene deshmitarja kete pune live permes internetit qe ta shohin personat jashte shtetit, se ka me ardhë nje doktorr me kontrolluar mos ka ndonje shenje, ndonje operacion, mos ke nerva apo mos ke ndonje semundje ne zemer, dhe duhet te zhveshen lakuriq, mirëpo dëshmitaret nuk kanë pranuar kushte të tillë dhe nuk kanë komunikuar më tepër me të akuzuarin.

Deshmitarja Sh.B. në deshmime e saj ka deklaruar se kunata e saj, bashkeshortja e vëllaut të saj S.B., ia kishte dhënë numrin e bashkeshortit të deshmitares një personi të cili deshmitarja e njeh si A., që ky person tua rregulloj dokumentacionin që deshmitarja me familje të dalin jashtë Kosovës në Austri apo në ndonjë shtet tjetër. Fillimisht i akuzuari kishte biseduar me bashkeshortin e deshmitares e pastaj kishte kërkuar edhe numrin e deshmitares që të bisedonte me të rreth procedurave për të dalë jashtë shtetit. I akuzuari kishte kërkuar nga deshmitarja që të fotografohet krejt e zhveshur por deshmitarja nuk kishte pranuar, pas insistimit të akuzuarit ajo kishte pranuar që të fotografohet me rroba të brendshme, gjithashtu i akuzuari i kishte thënë se duhet ta pastroj një plak e nëse nuk gjen ndonjë plak atëherë duhet ta pastroj të akuzuarin, për qka deshmitarja kishte pranuar, më pas nuk e kishte pastruar të akuzuarin, por kishte bërë fotografi ku kishte qenë së bashku me kunatën R. , dhe A.P shoqën e R. . Ato i kishte fotografuar vet deshmitarja pasi që ato nuk kishin pranuar që i akuzuari të fotografoj, ndërsa deshmitarën e kishte fotografuar vet i akuzuari, kjo kishte ndodhur në një shtëpi dhe fotot i kishin bërë me një lloj aparati që kishte qenë si kamerë. Me të akuzuarin kishte pasur kontakte edhe pas kësaj por nuk kishte pasur marrëdhënie seksuale me të edhe pse i akuzuari i kishte kërkuar. I akuzuari ia kishte kërkuar fotokopjen e letrënjoftimit të saj dhe burrit dhe qertifikatat e djemve.

Gjykata u ka besuar deklaratave të dëshmitareve-demtuarave sepse janë të qarta, të besueshme, në përputhje me njëra-tjetrën, dhe pjesërisht edhe me mbrojtjen e të akuzuarit të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor sepse janë të qarta, të besueshme, në përputhje me njëra-tjetrën, dhe pjesërisht edhe me mbrojtjen e të akuzuarit e duke analizuar deponimet e dëshmitarëve të përmendur si më lartë. Gjykata duke analizuar dëshminë e dëshmitares Sh.B. të cilës ia falë besimin, sepse dëshmia e saj ka qenë bindëse dhe argumentuese dhe ka qenë në përputhje edhe me dëshmitë e dëshmitarëve dhe pjesërisht me mbrojtjen e të akuzuarit, pasi që të njëjtit kanë treguar se i akuzuari kishte kërkuar nga deshmitarja që të fotografohet krejt e zhveshur por deshmitarja nuk kishte pranuar, pas insistimit të akuzuarit ajo kishte pranuar që të fotografohet me rroba të brendshme.

Nga transkriptet e komunikimeve telefonike gjakata ka vërtetuar se i akuzuari i ka telefonuar personat të ndryshëm mes tyre edhe të demtuarave, Sh.B. dhe burrit të saj, deshmitares Gj.Sh. , H.K. por edhe personat tjerë, të cilët i joshë duke i ofruar mundësinë që pa para të dalin jashtë vendit për të punuar, i akuzuari prezantohet me emrin A. dhe se është nga Opoja por nga fshatra të ndryshëm dhe se gjoja është duke punuar perkohësisht në Austri. I akuzuari i zgjedhë zakonisht familjet e verfera, kryesisht bisedon me femra të cilave iu ofronë punë jashtë vendit në shtëpitë e pleqve duke iu percaktuar edhe se qfarë kushtesh duhet të plotësojnë dhe atë se duhet të fillimisht të fotografohen të zhveshura, se duhet të pastrojnë ndonjë plak dhe të inqizohen gjatë pastrimit që përmes internetit inqizimin ta dërgoj jashtë që ta shohin personat jashtë vendit, gjithashtu i njëjti përmes telefonit cakton takime me të demtuarat dhe familjarët e tyre.

Në raportin e ekspertizës laboratorike për ekzaminimin e kompjuterëve AKF. - ... të datës 06.04.2014 së bashku me CD dhënë konstatimi dhe mendimi përfundimtar se dëshmia D#A1 telefon SonyEricsson K770i IME..... nuk ka mundur të ekzaminohet sepse për arsye të panjohura nuk ka mundur të ndizet.

A2 Telefon LG A200 IMEI është ekzaminuar me pajisjen CellDek, kurse sim kartela Vala është ekzaminuar me programin SimCon, të gjitha të gjetura janë pjesë e raportit final.

Deshmia D#3 Kompjuter me mbishkrimin Delux SN_N/N Hard disk WesternDigital 80 GB SN_WCAMD..... eshte ekzaminuar me programin EnCase, mirepo ne kete paisje nuk eshte gjetur ndonje video apo fotografi te mundshme te cilat jane kerkuar ne urdhrese dhe te cilat kane te bejne me rastin ne fjale.

Sa i perket vepres penale te dhunimit nga neni 230 par. 1 te KP gjykata konstatoi se me asnje prove nuk eshte provuar se i akuzuari ka kryer kete veper penale. Ne te vertete lidhur me kete vepr penale ka qene vetem deklarata e deshmitares-demtuares S.A. nga e cila deklarate nuk eshte vertetuar kryerje e vepres penale. Lidhur me kete veper penale nuk eshte kontestuese se i akuzuari ka pasur marrredhenje seksuale orale me deshmitaren S.A. ne” ...-..”. Aktakuza te akuzuarin mes tjerash e akuzon se “...e dërgon në toalet dhe detyrimisht kërkon të bëj marrëdhënie, pasi e dëmtuara refuzon, atëherë e bindë që pa pëlqimin e saj të kryej akt oral seksual” ne realitet eshte vet deshmitarja S.A. e cila ka deklaruar se ajo vet ka shkuar ne toalet, se i akuzuari ka ecur perpara e ajo ka shkuar pas tij, se e njejta ka mundur qe te mos shkoj ne toalet, por ka shkuar se i akuzuari tan kohen e kishte thirre qe te shkonte prandaj edhe ka shkuar, gjate aktit seksual e demtuara e ka perdorur doren e saj, po ashtu ka ndegjuar zhurma te njerzve te cilet dy tri here kane trokitur ne deren e toaletit, por ajo nuk kishte kerkuar ndihme, qe sipas gjykates e njejta po te ishte e detyruar qe te kryente aktin seksual pa deshiren e saj dhe me dhune do te kerkonte ndihme, sidomos duke pasur parasyshe se qenda tregtare” ...-..” ka qene nje nder qendrat me te medha ne Prizren, rasti ka ndoshur ditën kur kane frekuentuar nje numer i madh i njerzve dhe ka pasur disa hyrje dalje ne kete qender.

Nder veprimet kryese qe i vihen ne barre te akuzuarit me akuze eshte edhe se”.... nëse nuk e bënë këtë(aktin seksual) dhe nuk del përsëri me mua për të kryer marrëdhënie, do të qes në internet të gjitha fotografitë tua duke bërë marrëdhënie me mua, se do ta prishi punën dhe jetën kur të martohesh dhe kam me i tregue burrit që ke pas marrëdhënie me mua” e qe veprimet e tilla nuk jane provuar fare, vet e deshmitarja ka deklaruar se nuk e din se qfar fotografi pasi qe e demtuara nuk ishte zhveshur qe ai ta fotografonte, nuk ka ndodhur qe i akuzuari te kete bere fotografi deri sa kane qene bashke, por se ka mundur qe “tinza” ku fytyren e te demtuares me trupin e dikujt tjetër ta postoj ne facebook gjithashtu e njejta ka deklaruar lidhur me postimin e fotove ne facebook se ate dite i akuzuari nuk i kishte thene se do ta nxjerr foto ne facebook, mirepo keto fjale ia kishte thene pas ketij rasti, ndersa nuk e pershkruar kurrfar veprimi te dhunes te kryer nga i akuzuari, ndersa sa i perket veprimete-fjaleve te akuzuarit “se do ta prishi punën dhe jetën kur të martohesh dhe kam me i tregue burrit që ke pas marrëdhënie me mua” deshmitarja ne asnje pjese te deshmise se saj nuk deklaronte se i akuzuari tia ket thene keto fjale.

Gjykata ka konstatuar se edhe nga provat materiale te administruara dhe ate nga ekspertiza laboratorike per ekzaminimin e kompjuterve nga e cila ekspertize eshte vertetuar se disa paisje nuk kane mundur te ekzaminohen ndersa nga ekzaminimi i kompjuterit me mbishkrimin Delux SN_N/N Hard disk WesternDigital 80 GB SN_WCAMD..... nuk eshte gjetur ndonje video apo fotografi te mundshme te cilat jane kerkuar ne urdhrese dhe te cilat kane te bejne me rastin ne fjale, pra edhe nga keto prova materiale te administruara nuk eshte provuar se i akuzuari te kete kryer vepren penale te dhunimit nga neni 230 par 1 te KP, prandaj ne mungese te provave gjykata te akuzuarin e liroi nga akuza per kete veper penale pasi qe nuk eshte provuar se i akuzuari ka kryer kete veper penale.

Sa i perket vepres penale degradimi i integritetit seksual nga nenni 233 par. 1 te KP nga të gjitha provat e administruara gjykata konstatoi se ne raport me të dëmtuarat e paraqitura në akuzë Drita Temo, Hatixha Keryeziu dhe Gjylferie Shala gjykata ka vërtetuar se nuk formohen elementet e veprës penale që i vihet në barrë të akuzuarit në raport me këto dëshmitare, kjo për faltin se nga vet dëshmitë e këtyre dëshmitareve vërtetohet dhe nuk është kontestuese se i akuzuari me të vërtetë ka komunikuar dhe është takuar me to, gjithashtu nuk është kontestuese se i akuzuari u ka ofruar që të njëjtat të dalin jashtë duke u përcaktuar kushte të ndryshme dhe atë se se duhet të bëjnë një kontrollë gjinekologjike gjoja tia bente një analize se mos janë të infektuar apo të semura, gjithashtu i kishte thene se duhet ta laj-pastrojnë te akuzuarin se si e bene dëshmitarja kete pune live permes internetit qe ta shohin personat jashte shtetit, se ka me ardhë një doktor me kontrolluar mos ka ndonje shenje, ndonje operacion, mos ke nerva apo mos ke ndonje semundje ne zemer, dhe duhet te zhveshen lakuriq, mirëpo dëshmitaret nuk kanë pranuar kushte të tillë dhe nuk kanë komunikuar më tepër me të akuzuarin. Pra dëshmitaret përveq se kanë biseduar me të akuzuarin rreth shkuarjes jashtë vendit për të punuar dhe kushteve të cilat i akuzuari ua ka paraqitur se duhet ti plotësojnë nuk kanë ndërmarrë veprime rreth plotësimit të këtyre kushteve, andaj gjykata konsideron se veprimet kryese të cilat i ngarkohen me akuzë të akuzuarit nuk formohen elementet e veprës penale degradimi i integritetit seksual nga nenni 233 par. 1 te KP që i ngarkohet të akuzuarit në drejtim të dëshmitareve-dëmtuarave Drita Temo, Hatixha Keryeziu dhe Gjylferie Shala.

Sa i përket veprimeve kryese të veprës penale degradimi i integritetit seksual nga nenni 233 par. 1 te KP në drejtim të dëmtuarave Sh.B. , A.P. dhe R.F. nuk është kontestuese dhe ne tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer kete veper penale. Ne te vertete edhe pse i akuzuari eshte deklaruar i pafajshem i njejti i ka pranuar veprimet kryese, i njejti e pranon se A.P.dhe R.F. e kishte njohur përmes Sh.B. , me to ishte takuar në prezencën e burrave të tyre, burri i Sh.B., M. e kishte telefonuar të akuzuarin dhe i akuzuari i kishte thënë që të vinë në Prizren, ishin takuar në stacionin e autobusëve ku kishin biseduar qe i akuzuari do ti dërgoj jashtë dhe do të i punësoj ne dom-shtepi te pleqve ku ishte prezentuar me emrin A. . Me Sh.B. , A.P. dhe R.F. kishin shkuar në firmën “” ku i akuzuari kishte punuar për të i fotografuar ato me kusht që të ishin të shëndosha dhe jo të operuara. Në atë vend kishin shkuarës bashku me kerr kishin hyrë mbrenda në atë shtëpi ato kishin shkuar në katin e dytë Sh.B. ia kishte dhënë digritronin për ti fotografuar.

Nje deklarate e tille e te akuzuarit perputhet edhe me deklaratat e te demtuarave keshtu qe nuk eshte kontestuese dhe ne teresi eshte vertetuar se i akuzuari te demtuarave i kishte thene se do te shkoni jasht Kosove me i pastru, ruajt pleqte ne shtepi te pleqve, i ishte thene se duhet fotokopja e leternjoftimit, qertifikata e lindjes dhe ti bejne analizat, per qka kane shkuar ne nje shtepi ku nuk ishte askush, ka qene nje vullkanizer posht shtepie nalt ishte nje dhome, aty kishte punuar me heret i akuzuari, ka pas nje banjo, aty te demtuarat e kane kryer urinen gjoja per ti kryer analizat per mos me pas operacione ne trup iu ka ba edhe foto te cilat i kishte bere Sh.B. ndersa i akuzuari kishte qendruar jashte dhomes, foto i kishte bere me nje instrument i cili nuk dukej si aparat dhe nuk ka shkreper si aparat por dukej si digitron i televizorit, Sh.B. e kishte mesuar i akuzuari se si te fotografonte, por foto asnjehere nuk kishin pa. Para se ti benin foto i akuzuari i kishte kerkuar qe tua shoh trupin te zhveshur, ai i kishte kerkuar qe foto ti benin me rreoba te brendshme, I akuzuari kishte kerkuar nga dëshmitarja Sh.B. qe te fotografohet krejt e zhveshur por dëshmitarja nuk kishte pranuar, pas insistimit te akuzuarit ajo kishte pranuar qe te fotografohet me rroba te brendshme, gjithashtu i akuzuari i kishte thene se duhet ta pastroj nje plak e nese nuk gjen ndonje plak ateher duhet ta pastroj te akuzuarin, per qka

deshmitarja kishte pranuar, mirepo nuk e kishte pastruar te akuzuarin, por kishte bere fotografi ku kishte qene se bashku me kunaten R.F., dhe A.P. shogen e R.F. . Ato i kishte fotografuar vet deshmmitarja pasi qe ato nuk kishin pranuar qe i akuzuari ti fotografuoj, ndersa deshmitemaren e kishte fotografuar vet i akuzuari, kjo kishte ndodhur ne nje shtepi dhe fotot i kishin bere me nje lloj aparati qe kishte qene si kamere.

Sa i perket vepres penale mbajtja ne pronesi, kontrolle ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374/1 KP-se gjykata gjendjen e ketille faktike e ka vertetuar nga vet pranimi i fajesisë nga i akuzuari i cili e ka pranuar fajesinë gjate shqyrtimit gjyqësor. Gjykata ka konstatuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimi te fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij avokatin H.K. , pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Sipas bindjes së gjykatës në veprimet e të akuzuarit, e në mënyrë më afër të përshkruar në shqiptimin e këtij aktgjykimi formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të degradimi i integritetit seksual nga neni 233 par. 1 te KP dhe veprën penale të sulmit nga neni 187 paragrafi.1 të KPK-së, për këte edhe ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për këto vepra penale, pasi që në tërësi ka gjetur se i akuzuari është juridiko penalisht përgjegjës dhe se nuk egziston asnjë rrethan e cila do të përjashtonte përgjegjësin e tij penalo juridike.

Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat gjykata këtu të akuzuarin S.G. e shpalli fajtor për veprën penale të dhunimit nga neni 230 paragrafi.1 të KP-së dhe veprën penale mbajtja në pronesi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374/1 KP-së dhe të njëjtit i shqiptojë dënimet, më afër të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konform nenit 73 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtin duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë. Gjykata si rrethana lehtësuese ka vlerësuar se i akuzuari është person i moshës së re, se është i gjendjes së varfër ekonomike. Andaj, është vlerësim i gjykatës që dënimet e shqiptuara do ta arrijnë qëllimin e vet konform nenit 41 të KPK, se dënimet e shqiptuara janë në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se do të mundësoj një balancë të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale. Gjykata vlerëson se dënimet e shqiptuara të akuzuarit janë në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaçërisht të asaj të posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe është në pajtueshmëri me kërkesat për siguri personale të popullatës së kësaj treve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KP në të gjitha segmentet e tij. Dënimet e shqiptuara për kah lloji dhe lartësia janë në harmoni me rrethanat e rastit, ë nevojshme dhe të mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit konform dispozitës së lartcekur. Dënime e shqiptuara të akuzuarit sipas gjetjes së gjykatës është në harmoni dhe në baraspeshë me peshën e veprës së kryer penale dhe se kur të merret parasysh shkalla e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale,

dënimet e këtilla paraqiten si të domosdoshme me qëllim të arritjes së qëllimit të dënimit, me to shprehet gjykimi i shoqërisë për shkak të veprës së kryer penale dhe forcohet obligimi i respektimit të ligjit.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike është marrë në bazë të nenit 463 par.2 të KPP të Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 450 të KPP të Kosovës.

Si u cekë edhe më lart u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr. 19/2015 datë 23.06.2016

Procesmbajtësja
Birsen Kume

Kryetari i trupit gjykues,
Skender Çoçaj

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit – Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.